



# Ekonomia Shqiptare në frontin e luftës së padukshme!

RAPORT  
MONITORIMI



AUTOR  
ILDA  
METHASANI

QENDRESA  
QYTETARE



NED

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

# Përmbajtja

## Hyrje

1. Ndikimi i luftës Rusi-Ukrainë në ekonominë e vendit tonë
2. Përkeqësimi i situatës ekonomike për qytetarët
3. Reagimi qytetar dhe i qeverisë në lidhje me situatën ekonomike
  - Paketa e rezistencës sociale
  - Bordi i administrimit të hidrokarbureve
  - Bordi i monitorimit të çmimeve të ushqimeve të shportës

## Përfundime

## Hyrje

Pushtimi rus i Ukrainës tronditi ekonominë botërore, që ende nuk ishte rimëkëmbur plotësisht nga goditja e pandemisë. Sulmi i armatosur erdhi pas javësh të tëra tensionesh që futën në krizë ekonominë botërore, duke ndikuar në rritjen e çmimit të energjisë.

Shumë analistë të fushës së ekonomisë<sup>1</sup> por edhe më gjerë kanë përpiluar skenarët e mundshëm se si do të vijojë situata politiko-ekonomiko-sociale në periudhën afatgjatë, ku natyrisht, është e pamundur të shterohen të gjitha mundësitë. Këto parashikime janë të përqendruara në ekonominë kryesore në botë, por vendet kudo në glob pritet të ndikohen nga rritja e çmimeve të mallrave, të ushqimeve kryesore dhe energjisë. Problematika kryesore lidhet me familjet që shpenzojnë një pjesë gjithnjë e më të madhe të të ardhurave të tyre për karburant dhe ngrohje, të cilat të ndikuara nga konflikti dhe ndryshimet e çmimeve, do të kenë më pak para për mallra dhe shërbime të tjera.

Në vendin tonë rritja e çmimeve ka filluar që në periudhën e shtatorit të vitit 2021 e në vijim, e shkaktuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Ndonëse kjo është një krizë globale, së cilës nuk do t'i shpëtojmë dot, situata e luftës Rusi-Ukrainë ishte vetëm krisja e fundit që theksoi më tej problemet ekonomike me të cilat po përballej vendi ynë.

Si shkak i rritjes së çmimit të karburanteve me 40%, në Shqipëri filluan protestat nga mesi i javës së dytë të marsit. Protestat kërkonin ndalimin e rritjes së çmimeve, rrjedhimisht duke pasqyruar pakënaqësinë e qytetarëve me situatën ekonomike dhe standartin e jetesës në vend.

Në fillim të “krizës së çmimeve”, qeveria mbajti një qëndrim neutral, duke theksuar faktin që jemi në një sistem demokratik, me ekonominë e tregut të lirë, ku qeveria nuk duhet të ndërhyjë në sjelljen e çmimeve. Ky qëndrim vjen në kushtet kur hendeku mes te pasurve dhe të varfërve në Shqipëri po zgjerohet gjithmonë e më shumë dhe ku qytetarët nuk arrijnë dot të përballojnë as të mirat dhe shërbimet më bazike.

---

<sup>1</sup>Revista Monitor, aksesuar online në:<https://www.monitor.al/tre-skenare-se-si-lufta-do-te-ndikojne-ne-ekonomine-globale/>

Pas vijimit konstant të protestave qytetare dhe zgjerimit në të gjithë vendin, qeveria reagoi duke miratuar Aktin Normativ, që vendos një normë dhe monitoron çmimet e shitjes së nënprodukteve të naftës për konsumatorët si dhe prezantoi Paketën e Rezistencës Sociale. Që nga deklarimi i këtyre masave, ka kaluar mjaftueshëm kohë dhe akoma ka paqartësi mbi efektin dhe impaktin e tyre për tu ardhur në ndihmë qytetarëve. A do të ketë një analizë nga autoritetet kompetente për të kuptuar se sa eficiente ishte Paketa e Rezistencës Sociale? A do të prezantohet një paketë e dytë nga ana e qeverisë?

Duke parë dita ditës rritjen e çmimeve, mungesën e politikave aktive dhe të qëndrueshme mund të themi që reagimi qytetar, për fat të keq, nuk arriti të kishte sukses në presionimin e qeverisë për masa dhe veprime konkrete. Ndërkohë që problemet thelbësore ekonomiko-sociale në vend vijojnë të injorohen, trekëndëshi i varfërisë (politik, ekonomik dhe shpirtëror) në Shqipëri vazhdon të njohë rritje dhe qëndrueshmëri në kohë dhe hapësirë.

### **Ndikimi i luftës Rusi-Ukrainë në ekonominë e vendit tonë**

Përgjatë pandemisë, qeveri të shteteve të ndryshme të botës mbështetën financiarisht përmes paketave dhe masave të ndryshme biznesin dhe konsumatorët për të stimuluar kërkesën dhe ofertën. Si rrjedhojë, pati një rritje të ndjeshme të kërkesës në nivel global. Në momentin që konflikti Rusi-Ukrainë kaloi në përballje të armatosur, një pjesë e lëndëve të para, si nafta apo energjia, patën një rritje të ndjeshme të çmimit, sepse Rusia dhe Ukraina janë dy vende që luajnë një rol shumë të rëndësishëm, në tregun europian, për sa i përket gazit, naftës dhe drithërave. Përtej zhvillimeve në arenën ndërkombëtare, në Shqipëri rritja e çmimeve u ndikua dukshëm nga "spekulimi". Në këtë kontekst, tregtarët, duke parë këtë rritje të ndjeshme të kërkesës dhe luhatjet e çmimeve në bursë, të ndikuar gjithashtu nga rritja e kostove të transportit, filluan të indeksnin çmimet në mënyrë të vazhdueshme.

Perspektiva e inflacionit është më e fortë sot se sa ishte para pandemisë. Para pushtimit të Ukrainës, ekonomia shqiptare si pjesë e tregut rajonal po shihte një rikthim pas ngadalësimit të krijuar nga bllokimi prej pandemisë. Sipas një sërë vlerësimesh, Shqipëria do të ketë vështirësi për t'u kthyer në situatat e favorshme ekonomike para krizës pandemike,

Kushtet e tregtisë të karakterizuara nga çmimet më të larta të energjisë mund të vonojnë më tej rritjen që është parashikuar në lidhje me ekonominë e Shqipërisë. Shtrenjtimi i faturave të produkteve të



energjisë tashmë llogaritet indirekt se ka ulur fuqinë blerëse të familjeve me rreth 1%<sup>2</sup> dhe po ndikon negativisht në besimin e konsumatorit. Me rikthimin e pesimizmit<sup>3</sup> në besimin konsumator, po shpenzohen gjithashtu rezervat financiare të krijuara gjatë pandemisë, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta.

Sipas ekspertëve ekonomikë, pavarësisht se volumi tregtar i Shqipërisë me Rusinë dhe Ukrainën është i ulët, pasojat prej luftës janë të pashmangshme, bazuar në të dhënat e mëposhtme:

- Shqipëria importon grurë dhe miell për të plotësuar nevojat e saj. Pjesën më të madhe, rreth 50%, e importon nga Rusia dhe Ukraina, pjesën tjetër nga Serbia, Rumania dhe Bullgaria. Prodhimi nga fermerët vendas arrin vetëm 250 mijë ton grurë në vit;
- Sipas të dhënave zyrtare nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë<sup>4</sup>, Shqipëria realizoi në vitin e kaluar, kryesisht nga importet me Rusinë dhe Ukrainën, vetëm 2.7% të volumit të tregtisë së jashtme ose 157 milionë euro. Nga Rusia dhe Ukraina, Shqipëria importon 50% të sasive vjetore të drithërave;
- Shqipëria importon nga Rusia 12% të naftës;
- Sektori i turizmit është një ndër sektorët që do ta ndjejë peshën e mungesës së turistëve nga Ukraina dhe Rusia. Sipas të dhënave të Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë, turistët nga Ukraina përbënin vitin e kaluar 22% të lëvizjeve me charter me destinacion Shqipërinë dhe kanë qenë grupi i dytë më i madh pas polakëve.

## **Përkeqësimi i situatës ekonomike dhe reagimi qytetar**

Në shtator, inflacioni u rrit në 2.5%, niveli më i lartë që nga janari 2017<sup>5</sup>, i udhëhequr nga shtrenjtimi i ushqimeve bazë dhe karburanteve. Konsumatorët po paguajnë më shumë për bukën, orizin, miellin, qumështin, karburantin etj. Tendenca pritet të vijojë, të paktën në periudhën afatshkurtër.

<sup>2</sup>Altax, aksesuar online nw: <https://altax.al/efektet-ekonomike-te-luftes-ne-ukraine-rrathet-e-ndikimit-drejt-shqiperise-dhe-botes/>

<sup>3</sup>Rikthehet pesimizmi, Treguesi i besimit në ekonomi e nis me rënie vitin 2022 - Revista Monitor aksesuar online nw: [www.monitor.al](http://www.monitor.al)

<sup>4</sup>Shqipëri: Lufta në Ukrainë dhe efekti i mundshëm në ekonomi, Aksesuar online në: [www.dw.com](http://www.dw.com)

<sup>5</sup>Revista Moinitor – aksesuar online nw: <https://ëëë.monitor.al/ritja-e-cmimeve-si-pandemia-kap-mat-geverine/>

Çmimet e disa produkteve kryesore në tregun e pakicës (lek)					
	Janar 2022	16 mars 2022	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %	
1	Uje mineral 1.5L	46.9	50	3.1	6.6
2	Qepw 1kg	70.1	65	-5.1	-7.3
3	Patate 1kg	71.7	71	-0.7	-1.0
4	Gaz 1L	85.1	93	7.9	9.3
5	Portokalle 1kg	95.1	100	4.9	5.2
6	Sheqer 1kg	89.2	120	30.8	34.5
8	Miell 1kg	99.2	135	35.8	36.1
9	Bukë 1kg	119.7	140	20.3	17.0
10	Mollë 1kg	95.7	110	14.3	14.9
11	Domate 1kg	131	150	19.0	14.5
12	Qumësht I freskët 1l	120.3	160	39.7	33.0
13	Kos natyral 1kg	129.1	150	20.9	16.2
15	Limonë 1kg	132.4	140	7.6	5.7
16	Makarona 1kg	190.9	230	39.1	20.5
17	Veze 1 kokërr	17	21	4.0	23.5
18	Oriz 1kg	157.5	170	12.5	7.9
19	Nafte 1L	180.7	203	22.3	12.3
20	Benzinw 1L	183.4	203	19.6	10.7
21	Gjizë 1kg	203	250	47.0	23.2
21	Vaj lule dielli 1L	228.1	320	91.9	40.3
23	Speca 1kg	163.9	220	56.1	34.2
24	Kastraveca 1kg	185.6	160	-25.6	-13.8
25	Ullinj 1kg	255.5	300	44.5	17.4
26	Fasule 1kg	275.1	320	44.9	16.3
27	Djath I bardhë 1kg	570.2	700	129.8	22.8
28	Gjalp 1kg	682.2	1000	317.8	46.6
29	Mish viçi 1kg	914.2	950	35.8	3.9
30	Djathë kaçkavall 1kg	809.4	1000	190.6	23.5
	<b>Totali</b>	<b>6302.2</b>	<b>7531</b>	<b>1228.8</b>	<b>19.5</b>

*Burimi: INSTAT per janar 2022, njesite e shitjes me pakice ne Tirane, mars 2022*

Në shtator, inflacioni i Eurozonës arriti nivelin më të lartë në 13 vjet, në 3.4%. Sipas Bankës së Shqipërisë, ecuria e çmimeve të mallrave bazë, apo të atyre të konsumit në tregjet ndërkombëtare, ushtron rol të rëndësishëm në përcaktimin e dinamikës së çmimeve në Shqipëri.

Ekspertët e ekonomisë dhe grupet e biznesit pohojnë se luftërat janë kriza të përkohshme që zgjidhen me masa të përkohshme, por problematika qëndron në faktin se ekonomia shqiptare ka probleme strukturore, që pengojnë shpërndarjen e drejtë të rritjes ekonomike, edhe në kohë normale. Më poshtë janë disa nga treguesit që shpjegojnë këto problematika:

1. Rreth 41% e shpenzimeve totale të një familjeje shqiptare shkojnë për ushqime dhe pije jo-alkoolike, një përqindje që është më e larta në rajon dhe në Europë, sipas të dhënave të Eurostat, që i referohen vitit 2019 dhe INSTAT për Shqipërinë. Lufta në Ukrainë, i ka çuar çmimet në nivelet më të larta historike, duke ndryshuar ndjeshëm tendencat e konsumit.
2. Për shkak të nivelit të ulët të të ardhurave (31% e mesatares së Bashkimit Europian, ndër të fundit në Europë) dhe peshës së lartë që zënë shpenzimet e ushqimeve në totalin e buxhetit të

familjeve (gati 42% në 2020-n) efektet e rritjes së çmimeve në familjet shqiptare pritet të jenë më të mëdha, duke ndikuar negativisht në shtimin e varfërisë në vend.<sup>6</sup>

3. Banka Botërore, në një raport të fundit të vitit 2021, gjeti se Shqipëria ka nivelin më të lartë të varfërisë në rajon, me 30.8% të popullsisë që vlerësohet se jeton në varfëri me më pak se 5 dollarë në ditë (sipas fuqisë blerëse) për vitin 2021, më e larta në rajon (e dyta pas nesh, Kosova e ka 24.4%, dhe më i ulëti, Mali i Zi, 16%). Ky është një tregues i qartë se rishpërndarja e burimeve dhe politikat e investimeve nuk kanë ndikuar në përmirësimin e mirëqenies së familjarëve (për këtë arsye, pesha e shpenzimeve për ushqime vijon të mbetet më e larta në rajon dhe Europë).
4. Vendi ynë ka nivelin më të ulët të të ardhurave për frymë në Europë në raport me mesataren e BE-së, por nga ana tjetër niveli i çmimeve në vendin tonë është ndër më të lartat rajonale, duke iu afruar më shumë mesatares së BE-së për vitin 2020. Eurostat përlloragriti në 2020 se çmimet e artikujve ushqimore në Shqipëri ishin sa 83.4% e mesatares së BE-së dhe gjithashtu niveli më i lartë në rajon.
5. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), Shqipëria mban nivel rekord. Sipas Eurostat, shpenzimet konsumatorë finale për ushqime dhe pije jo joalkoolike ishin sa 31.5% e PBB-së në vitin 2019, ndërsa vendi i dytë pas nesh është Mali i Zi me 22.7% të PBB-së. Mesatarja e BE-s-së për këtë tregues është vetëm 6.8% e PBB-së.
6. Kriza e shkaktuar nga pandemia në vitin 2020 ka sjellë ndryshime në strukturën e shpenzimeve për familjen. Rritjen më të ndjeshme e kanë shënuar shpenzimet për shëndetin, duke reflektuar faktin që shumë njerëz u detyruan që ta përballonin virusin me shpenzimet e veta. Sipas INSTAT, pesha e shpenzimeve për shëndetin u rrit në 5.4% në vitin 2020, nga 4.3% vitin e mëparshëm. Në vlerë, shpenzimet për shëndetin u rritën me 28%, duke arritur në rreth 4,500 lekë në muaj. Sipas INSTAT, shpenzimet e bëra në grupin "Shëndet" në vitin 2020 kanë pësuar rritjen më të lartë prej

<sup>6</sup> Revista Monitor – Aksesuar online në: <https://www.monitor.al/familjet-shqiptare-shpenzime-rekord-ne-europe-per-ushqime-pse-i-rendon-me-shume-ritja-e-cmimeve/>

28,0 %, krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të madhe të shpenzimeve për nëngrupin “vitamina”.

Pavarësisht statistikave të përmendura më sipër vazhdojmë të jemi në kushtete e mungesës së një minimumi jetik, mos indeksimit të rregullt të pagave dhe pensione, mos mbrojtje e konsumatorit në rritjen spekulative të çmimeve për të mirat dhe nevojat bazë si dhe mungesë e theksuar dhe e vazhdueshme e politikave aktive, transparente dhe profesionale, dhe mbi të gjitha mungesa e vëmendjes për të paraprirë dhe adresuar vështirësitë ekonomike. Skema e mbrojtjes sociale në vendin tonë është e papërfillshme dhe e prapambetur kundrejt sfidave ekonomike të qytetarëve.

Pesha e lartë e shpenzimeve për ushqime, niveli i ulët i të ardhurave dhe rritja e këtyre të fundit me ritme të ulëta, i bën automatikisht familjet shqiptare më të prekura nga rritja e çmimeve.

## Reagimi qytetar dhe i qeverisë në lidhje me situatën ekonomike

Protestat në Shqipëri filluan nga mesi i javës së dytë të marsit kur çmimi i karburanteve u rrit me më shumë se 40% dhe qeveria deklaroi se tregjet europiane dhe ato ndërkombëtare të karburanteve kanë pësuar luhatje nga lufta në Ukrainë. Protesta e së shtunës së datës 12 Mars shënoi një pjesëmarrje më të madhe se ato parë të tri ditëve më parë. Protestuesit morën fjalën para godinës së kryeministrit me një kërkesë të njëjtë: ndalimin e rritjes së çmimeve. Gjatë atyre ditëve u artikulua mjaft qartë pakënaqësia qytetare kryesisht në lidhje me situatën ekonomike dhe standartin e jetesës në vend.

Gjatë ditëve të protestave, qeveria zhvilloi një mbledhje ku u miratua Akti Normativ, që vendos një normë dhe monitoron çmimet e shitjes së nënprodukteve të naftës për konsumatorët. Në vazhdim, qeveria prezantoi **Paketën e Rezistencës Sociale** për të përballuar rritjen e çmimeve si pasojë e luftës mes Rusisë dhe Ukrainës. Në një komunikim për mediat, u bënë të ditura 7 pika të kësaj paketë, me qëllim që do t'u vijnë në ndihmë familjeve më në nevojë për të përballuar produktet ushqimore të shportës, të cilat kanë njohur rritje të çmimeve.

## Paketa e Rezistencës Sociale



1. Paketën e Rezistencës Sociale parashikon 3.3 miliardë lekë për indeksimin e pensioneve. Kjo masë do të reflektohet që në pensionin e radhës së 673.542 pensionistëve.
2. Qeveria do të kompensojë rritjen e çmimit të shportës me 3 mijë lekë në muaj për 3 muaj rresht, ku do të përfitojnë 576 mijë qytetarë. Nga kjo masë përfitojnë pensionistët që marrin më pak sesa gjysma e pagës minimale, pensionistët e invaliditetit, pensionistët që jetojnë vetëm, (në kuptimin individualisht apo në çift) si dhe persona me aftësi të kufizuar, paraplegjikë, tetraplegjikë apo të verbër dhe të gjitha familjet që janë aktualisht në skemën e ndihmës ekonomike.
3. Paketa e Rezistencës Sociale parashikon 1.45 miliardë lekë mbështetje për fermerët me naftë pa taksa.
4. Qeveria do mbështesë të gjithë shqiptarët që përdorin linja urbane qytetase dhe ndërqytetase, duke derdhur menjëherë 500 milionë lekë ose 5 milionë dollarë për të paguar diferencën e çmimit të biletës, në mënyrë që asnjë udhëtar të mos preket nga ndryshimi i çmimit, qoftë kur hipën në autobus brenda qytetit e qoftë kur hipën në një autobus për të shkuar nga një qytet në tjetrin.
5. Nga muaji prill do të zerohet taksa për pagat deri në 40 mijë lekë, do të përgjysmohet taksa mbi pagat deri në 50 mijë lekë dhe do të ulët taksa mbi pagat nga 150-200 mijë lekë.
6. Qeveria do tërheqë dy muaj përpara edhe futjen në fuqi të ligjit për pagën minimale, e cila në prill do bëhet 32 mijë lekë.
7. Paketa e Rezistencës Sociale, parashikon 28 miliardë lekë për të mbajtur të palëvizur çmimin e energjisë elektrike në faturat e familjarëve dhe bizneseve të vogla.

### **Interpretim:**

Shumica e ketyre pikave janë afrim në kohë i disa politikave që ishin parashikuar të viheshin në zbatim në një moment të dytë. Le të shohim disa nga këto pika:

Së pari, në lidhje me pensionet duhet përmendur që në vetvete skema aktuale është mjaft problematike. Për shkak të infomalitetit, largimit të

të rinjve (forcës punëtore apo e forcës kontribuese), dhe plakjes së popullsisë është ulur niveli i kontributeve duke e vendosur skemën aktuale (pay as you go) të pensioneve në vështirësi të konsiderueshme. Duke pasur parasysh mungesën e theksuar prej kohësh në rritjen apo indeksimin e pensioneve (e cila nuk duhet harruar që përbën një detyrim që ka kohë që nuk është përmbushur), kjo pikë e Paketës së Rezistencës Sociale është e papërfillshme dhe vetëm një masë simbolike.

Së dyti, Indeksi i çmimit të produkteve të shportës ka pësuar një rritje të ndjeshme ku pjesa dërrmuese e produkteve të shportës ka pasur një rritje me 20%. Nga ana tjetër kemi mbështetje të qeverisë me 3 mijë lekë për pensionistët që **marrin më pak se 16 mijë lekë në muaj** apo edhe për individët me ndihmë sociale. Mjafton të rikujtojmë faktin që 41% e buxhetit familjar shkon për blerjen e ushqimeve të shportës për jetesë të përditshme për të kuptuar “lehtësirat” që kjo masë suplementare mund të ketë për grupet që e përfitojnë.

Së treti, rritja e pagës minimale si dhe afrimi në kohë i zbatimit të këtij ligji mund të zërthehet si një kosto për biznesin e cila në fund të ditës mund të transferohet në xhepat e qytetareve duke rritur çmimin e shërbimeve dhe produkteve që bizneset ofrojnë.

Që nga deklarimi i Paketës Sociale dhe me përfundimin e aplikimit të kësaj pakete në maj, lind nevoja për një analizë. Duke ditur që qëllimi i paketave sociale është të shërbejnë për rishpërndarjen e të ardhurave për grupet në nevojë, a ishte ky rasti i kësaj pakete apo ishte thjesht në veprim nën presion që nuk pati asnjë impakt në lehtësimin e situatës së krizës së cmimeve në vend? Sa rezistente ishte kjo paketë sociale? A do të ketë një paketë të dytë sociale? Po një analizë nga autoritete kompetente se sa eficiente rezultoi paketa e parë në mënyrë që një paketë e dytë të jetë më efiçente?

### **Krijimi i Bordeve:**

Në Fletoren Zyrtare është botuar akti normativ “Për transparencën dhe monitorimin e çmimeve për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg” në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës i miratuar nga qeveria. Akti normativ përcakton se bordi do të monitorojë çdo javë çmimet e produkteve, sipas listës së miratuar prej tij dhe do të vendosë marzhin e fitimit. Subjektet e shumicës që nuk respektojnë vendimet e bordit do të penalizohen me gjoba deri 10 mln lekë, ndërsa për

tregtarët e vegjël masa administrative do të jetë 2 mln lekë. Përsëritja e shkeljeve do të dënohet me mbyllje të aktivitetit deri në sekuestrimin e mallit.

Vendimet e bordit janë të detyrueshëm të zbatohen nga të gjitha subjektet dhe zbatimi i tyre monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet verifikimit të faturave të lëshuara nga subjektet gjatë periudhës së situatës së veçantë të krijuar në treg. Sipas rastit, Bordi mund të vendosë krijimin e një task-force, me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

### **Interpretim:**

Sërisht ka kaq shumë paqartësi dhe konfuzion në lidhje me “nevojën”, rolin dhe efektin e krijimit të këtyre strukturave. Në momente krize nuk është e nevojshme të ngrihen struktura të reja duke komplikuar edhe më tepër situatën, por me rëndësi është t'u sigurohet “fuqi funksionale” autoriteteve përkatëse dhe aktuale.

Për të kuptuar më shumë mbi filozofinë e funksionimit të këtyre bordeve, drejtuam pyetje organeve përkatëse në lidhje me numrin e gjobave që janë vendosur deri tani nga Bordi i Administrimit të Hidrokarbureve dhe Bordi i Transparencës së çmimeve të produkteve të shportës. Përgjigja tregonte se deri në 5 maj 2022, Bordi i Administrimit të Hidrokarbureve ka marrë vendim për një subjekt për dhënien e masës administrative “Pezullim license për 3 muaj për ushtrim veprimtarie dhe detyrimin për mosndryshimin e gjemdjës së produkteve të naftës dhe të gazit”, ndërsa Bordi i Transparencës së Çmimeve të produkteve të Shportës nuk ka vendim për masa administrative.

Disa elementë të tjerë që krijojnë pasiguri në lidhje me ngritjen e bordeve të monitorimit të çmimit:

- Monitorimi nuk është i nevojshëm të bëhet në terren, pasi institucionet e kanë informacionin me sa blihet nafta nga dogana dhe sa shitet te distributorët me pakicë;
- Me përcaktimin e një çmim tavan, e gjithë barra i kalon biznesit. Për shëmbull nëse i përcakton një operatori me pakicë që ti do ta shesësh me 100 lekë, kur ai e ka blerë me 110 lekë dhe ti i

përcakton atij një marzh fitimi minimal, pa marrë parasysh kur ai ka edhe kosto të tjera. Serbia përcaktoi një shumë tavan, duke subvencionuar vetë shteti diferencën; Kosova përcaktoi një marzh të ulët fitimi 4-6%; në Shqipëri e kemi 1-4%;

- Për sa i përket monitorimit të çmimeve në treg, janë zgjedhur vetëm katër produkte, ndërkohë që shporta mund të shkojë nga 20 deri në 30 produkte;
- Sot në treg janë shumë operatorë të tregtimit me shumicë dhe pakicë. Kjo gjë rrezikon një përqendrim edhe më të madh të tregut nga sa është tani, duke bërë që disa operatorë të vegjël mund të dalin nga tregu, duke bërë një përqendrim më të madh të tregut e operatorëve të mëdhenj.

### **A ka mundësi qeveria të bëjë më shumë për këto kategori?**

Sic u përmend dhe në hyrje të këtij punimi, rritja e çmimeve kishte filluar që në shtator të 2021. Qeveria, edhe pse në dijeni të një rritjeje të vazhdueshme të çmimeve nuk e mori në konsideratë që mund të kishte një rritje të ndjeshme të inflacionit.

Është detyrë e shtetit të parashikojë dhe të marrë masat e nevojshme paraprake për kohë krizash, ku në një buxhet të fillë si i vendit tonë, është e vështirë të ndërmerresh politika fiskale. Nga ana tjetër, situata nuk duket kaq negative për arkën e shtetit. Në një artikull nga revista Monitor, nga studimi rezulton që treguesit fiskale për 4-mujorin e parë të këtij viti dëshmojnë se të ardhurat për periudhën janar-prill janë rritur me 34.7 miliardë lekë ose rreth 284 milionë euro më shumë në raport me një vit më parë<sup>7</sup>. Pra, qeveria po "përfiton" nga situata në të cilën ndodhet, por qeveria duhet të sigurohet që këto të ardhura të rikthehen përsëri te konsumatorët

Në dukje, për shkak se të ardhurat tatimore janë në rritje mund të mendohet që ka hapësirë për të reduktuar normat e taskave, por ulja e taksave mund të mos rezultojë në ndihmë të konsumatorit. Tregjet në Shqipëri janë të segmentuar dhe në mungesë të konkurrencës. Nga eksperiencat e mëparshme ulja e TVSH-së nuk ka ulur çmimet (referuar uljes së TVSH-së në turizëm nga 20% në 6%, përjashtimi nga TVSH I biznesit të vogël në 2021, etj). Nga na tjetër, ne kemi një nivel të lartë

<sup>7</sup> Rritja e çmimeve mbush arkën e shtetit, 284 milionë euro më shumë në 4 muaj! Peshë, të ardhurat nga tatimet e doganat - Akseuar online nw: ([panorama.com.al](http://panorama.com.al))



borxhi si dhe presim që qeveria të ndërmarrë projekte zhvillimore me fondet saj pasi kemi nevojë për të ardhura. Nëse do të ulej një taksë, atëherë do të kishim efekt domino në grupe të tjera për ulje taksash që qeveria nuk do ta perballonte dot. E rëndësishme në këtë pikë është të mos rrisim borxhin dhe defiçitin pasi kjo do të ishin efekte të shtuara në krizë.

### **Përfundimet:**

1. Fatura më e rënduar e produkteve të energjisë tashmë llogaritet indirekt se ka ulur fuqinë blerëse të familjeve me rreth 1%<sup>8</sup> dhe po ndikon negativisht në besimin e konsumatorit. Me rikthimin e pesimizmit në besimin konsumator po shpenzohen gjithashtu rezervat financiare të krijuara gjatë pandemisë, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta, duke ulur shkallën në të cilën kursimi mund të mbështesë konsumin në të ardhmen.
2. Sipas ekspertëve, Shqipëria ndodhet në një varësi indirekte në rritje prej tregjeve të Rusisë dhe Ukrainës, ku pasojat prej luftës në Ukrainë janë të pashmangshme.
3. Rreth 41% e shpenzimeve totale të një familjeje shqiptare shkojnë për ushqime dhe pije jo-alkoolike, një përqindje që është më e larta në rajon dhe në Europë, sipas të dhënave të Eurostat, që i referohen vitit 2019 dhe INSTAT për Shqipërinë.
4. Rritja jo e zakonshme e çmimeve që nisi gjatë pandemisë dhe u intensifikua edhe më shumë pas luftës në Ukrainë, i ka çuar çmimet në nivelet më të larta historike. Rritja e çmimeve pritet të ndryshojë ndjeshëm tendencat e konsumit.
5. Vendi ynë ka nivelin më të ulët të të ardhurave për frymë në Europë në raport me mesataren e BE, por nga ana tjetër niveli i çmimeve në vendin tonë është ndër më të lartat rajonale, duke iu afruar më shumë mesatares së BE-së për vitin 2020. Eurostat përlllogariti se më 2020 çmimet e artikujve ushqimore në Shqipëri ishin sa 83.4% e mesatares së BE-së dhe gjithashtu niveli më i lartë në rajon.

<sup>8</sup><https://altax.al/efektet-ekonomike-te-luftes-ne-ukraine-rathet-e-ndikimit-drejt-shqiperise-dhe-botes/>

6. Pavarësisht krizës së çmimeve, vazhdojmë të jemi në kushtet e mungesës së një minimumi jetik, mos indeksimit të rregullt të pagave dhe pensioneve, mos mbrojtjes së konsumatorit në rritjen spekulative të çmimeve për të mirat dhe nevojat bazë si dhe mungesës së theksuar dhe të vazhdueshme të politikave aktive, transparente dhe profesionale, dhe mbi të gjitha mungesës së vëmendjes për të paraprirë dhe adresuar vështirësitë ekonomike.
7. Shumica e pikave të Paketës së Rezistencës Sociale janë afrim në kohë në lidhje me kohën kur ishin menduar të viheshin në zbatim. Indeksi I pensioneve dhe masa suplementare prej 3000 lekësh janë të papërfillshme duke pasur parasysh skemën e vafër të pensioneve në Shqipëri si dhe rritjen e lartë të çmimeve të shportës. Rritja e pagës minimale si dhe afrimi në kohë i zbatimit të këtij ligji, ekonomikisht mund të zërthehet si një kosto për biznesin e cila në fund të ditës mund të transferohet në xhepat e qytetareve duke rritur çmimin e shërbimeve dhe produkteve që bizneset ofrojnë.
8. Deri në 05/05/22 Bordi i Administrimit të Hidrokarbureve ka marrë vendim për një subjekt për dhënien e masës administrative "Pezullim license për 3 muaj për ushtrim veprimtarie dhe detyrimin për mosndryshimin e gjemdjës së produkteve të naftës dhe të gazit", ndërsa Bordi i Transparencës së Çmimeve të produkteve të shportës nuk ka vendim për masa administrative.
9. Disa problematika në lidhje me bordet e monitorimit:
  - Monitorimi nuk është i nevojshëm të bëhet në terren, pasi institucionet e kanë informacionin me sa blihet nafta nga dogana dhe sa shitet te distributorët me pakicë.
  - Me përcaktimin e një çmim tavan, e gjithë barra i kalon biznesit.
  - Për sa i përket monitorimit të çmimeve në treg, që janë zgjedhur vetëm katër produkte, ndërkohë që shporta mund të shkojë nga 20 deri në 30 produkte.
  - Sot në treg janë shumë operatorë të tregtimit me shumicë dhe pakicë. Kjo gjë rrezikon një përqendrim edhe më të madh të tregut nga sa është tani, duke bërë që disa operatorë të vegjël mund të dalin nga tregu, duke bërë një përqendrim më të madh të tregut e operatorëve të mëdhenj.

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



**NED**

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD